

Prishtinë, 07 maj 2007
ERO Kodi: D_47_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Mandatin e vet ligjor që i jepet në Nenet 45 deri në 48 të Ligjit Nr. 2004/09 "Mbi Rregullatorin e Energjisë";
2. Dispozitat e Rregullës mbi "Parimin e Kalkulimit të Tarifave në Sektorin e Energjisë (Rregullës mbi Çmimet)" të nxjerrë nga Bordi i ZRRE-së më 15 dhjetor 2005, dhe në veçanti pikat 30.2 a) & b) të rregullës së sipërpërmendur;
3. Dispozitat e Metodologjisë së tarifave të nxjerra nga Bordi i ZRRE-së më 15 dhjetor 2005;
4. Kërkesës së KEK Sh.A sipas letrës së tyre dërguar ZRRE-së më 25 prill 2007;
5. Kërkesës së KOSTT Sh.A sipas letrës së tyre dërguar ZRRE_së më 2 maj dhe kërkesës së modifikuar me 4 maj 2007;
6. Të dhënave të reja teknike dhe ekonomike të rishqyrtimit të çmimeve dhe veçanërisht heqjen e shpenzimeve kapitale për rinovimin e Kosova A3, A4 në vitin 2007 (€ 76 mil.) sipas pikës 4 të mësipërme, reduktimin në "Humbjet jo-teknike" të vlerësuara për 1%, sipas pikës 4 të mësipërme; reduktimin e shpenzimeve të KOSTT-it: të personelit për € 150,000, të Shërbimeve ndihmëse për € 210,000, dhe të Mirëmbajtjes për € 120,000, sipas pikës 5 të mësipërme;

Në seancën e Bordit më 7 maj 2007, ka vendosur të:

1. Rishikojë Vendimin D_29_2006 të datës 21 dhjetor 2006 mbi të "Hytrat e Lejuara për KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A për periudhën e rishqyrtimit të çmimeve 2007-2009" dhe të rishikojë Vendimin: D_39_2007 dhe D_41_2007 të datës 15 mars 2007 mbi "Tarifat e reja të propozuara me pakicë për KEK Sh.A dhe tarifat e transmisionit për KOSTT Sh.A";

ZRRE i fton të dyja palët, KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A, që më së voni deri më 10 maj 2007, t'i propozojnë dhe dorëzojnë ZRRE-së tarifat e azhurnuara me pakicë dhe ato të transmisionit që të rishikohen nga Bordi i ZRRE-së si pjesë e procesit të rishqyrtimit, me qëllim që tarifat e azhurnuara të hyjnë në fuqi nga 1 maji 2007.

2. Ky Vendim është nxjerrë në gjuhën: shqipe, serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

3. Ky Vendim hyn në fuqi më datën e lëshimit apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues,

Merita Kostari, anëtar,

Theranda Beqiri, anëtar

Nysret Avdiu, anëtar

Naim Bejtullahu, anëtar

Vendimi i dërgohet KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A dhe

Kopje:

Kryeministrit

Kryetarit të Kuvendit

ZPSSP Shtylla e IV

Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

MEM

MEF

MPMS

Zyra e Politikës Ekonomike/Shtylla e IV

Zyra për Çështje Fiskale/ Shtylla e IV

AKM